



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**

Nr. 190/18 Prot

Tiranë, më 13/02/2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

SHKOLLËS PROFESIONALE “HASAN GINA” LUSHNJË

LUSHNJË

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.09.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” i ndryshuar, ju njoftojmë shpalljen për vend të lirë si më poshtë:

Pozicioni i punës:

- Drejtor i Shkollës së Mesme Profesionale “Hasan Gina” Lushnjë

Kandidati aplikues për pozicionin e punës: Drejtor i Shkollës së Mesme Profesionale “Hasan Gina” Lushnjë, duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

2. Kriteret të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare Master Shkencor, ose të barasvlershëm me të;
- b) të ketë 3 (tre) vjet përvojë pune nga të cilat 1 (një) vit përvojë pune në menaxhim;
- c) të ketë njohuri të certifikuara të përdorimit të teknologjisë së informacionit;

d) preferohet të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe/ose të gjuhëve të huaja të tjera.

3. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 11 të Udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.09.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” i ndryshuar.

c) kartën e identitetit

d) diplomën

e) librezën e punës

f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura jetëshkrim;

g) certifikatë/a ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Afati njoftimit fillon më datë 16.02.2026.

Njoftimi bëhet në faqen zyrtare të AKPA-së, në faqen elektronike zyrtare të Shkollës së Mesme Profesionale “Hasan Gina” Lushnjë (nëse ka), si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Shkollës së Mesme Profesionale “Hasan Gina” Lushnjë. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Qendrore të AKPA-së, brenda datës 20.02.2026.

Struktura e vlerësimit të kandidatëve fitues në fazën e dytë është si më poshtë:

- Vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë;
- Vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë.

Në intervistë, ndër të tjerat, kandidati vlerësohet për:

- i. njohuritë e përgjithshme mbi legjislacionin, mbi të cilin rregullohet dhe organizohet veprimtaria e ofruesit të AFP-së.
 - Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar;
- ii. prespektivën e tij për zhvillimin dhe mirëadministrimin e Shkollës së Mesme Profesionale “Hasan Gina” Lushnjë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klevis HYSA

